

VENDIM
Nr.260, datë 18.4.2007

**PËR BOTIMIN, SHTYPJEN DHE SHPËRNDARJEN E TEKSTEVE SHKOLLORE, TË
SISTEMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, 56 e 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës miraton dhe certifikon tekstet shkollore të arsimit parauniversitar, të cilat konkurrojnë, në barazi të plotë, në përzgjedhje nga përdoruesit. Kriteret dhe procedurat e konkurrimit dhe të përzgjedhjes përcaktohen me udhëzim të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës.

2. Procesi i botimit, shtypjes, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore të arsimit parauniversitar bëhet nga shtëpitë botuese. Shtëpitë botuese, të cilat marrin përsipër ta kryejnë këtë proces, paraqesin tekstet, për miratim, në bazë të kriterëve dhe procedurave të parashikuara në udhëzimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës. Në udhëzim përcaktohen edhe afatet, skema e shpërndarjes dhe pikat e shitjes së teksteve shkollore të arsimit parauniversitar, sipas pikës 4 të këtij vendimi.

3. Drejtoritë arsimore në rrethe dhe zyrat arsimore (DAR/ZA-t) të blejnë drejtpërdrejt nga shtëpitë botuese tekstet shkollore, të cilat do t’u shërbejnë shkollave për përzgjedhje. Këto tekste blihen me fondet e Buxhetit të Shtetit dhe ruhen në bibliotekën e shkollës, si pronë e saj.

4. Shtëpitë botuese i shesin tekstet e certifikuar në mjedise shkollore. Në qytete, të cilat kanë librari, shitja e teksteve mund të bëhet edhe në librari. Drejtorët e shkollave detyrohen t’u ofrojnë mjedise shtëpive botuese për shitjen e teksteve. Tekstet për shkollat e pakicave kombëtare dhe të arsimit profesional shiten në shkolla, sipas porosive të tyre.

Çmimi i shitjes duhet të jetë jo më i lartë sesa çmimi, me të cilin janë paraqitur për miratim tekstet e certifikuar.

a) Librashitësit, të cilët i shesin tekstet shkollore me lekë në dorë, duhet t’i lëshojnë blerësit dokumentin e shitjes ose faturën e kasës fiskale, sipas modeleve të caktuara nga Ministria e Financave.

b) Në rastin e teksteve për shkollat e pakicave kombëtare dhe të arsimit profesional, shitja bëhet përkundëjt faturave. Faturat paguhen me pjesën e kontributit të nxënësit dhe subvencionin e caktuar për të, përmes llogarive buxhetore të DAR/ZA-ve ose vetë shkollës, kur ka llogari të tillë. Për këtë, shkollat dërgojnë dokumentacionin e plotë në DAR/ZA-n përkatëse. Pas plotësimit të kërkesave të shkollave, shtëpitë botuese mund t’i shesin këto tekste edhe në librari. Ministria e Arsimit dhe Shkencës nuk e subvencionon blerësin në shitjen e lirë të këtyre teksteve.

5. Tekstet duhet të jenë të pajisura me pullën me hologramë, të certifikimit, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Pulla me hologramë u shpërndahet botuesve nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, kundrejt pagesës. Tekstet, që tregtohen pa këtë pullë, i nënshtrohen procesit të konfiskimit, në përputhje me ligjet në fuqi.

6. Në rastet e subvencionimit të teksteve shkollore, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, fondet, e miratuara për këtë qëllim, ia jep blerësit, si kompensim për blerjen e teksteve ose i vë në dispozicion të tij, për t’i përdorur për këtë qëllim.

7. Procedurat e përdorimit dhe të shpërndarjes së fondeve buxhetore, të miratuara si subvencion për blerjen e teksteve shkollore, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë të Financave dhe të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

9. Vendimi nr.144, datë 3.8.2006 i Këshillit të Ministrave “Për botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar”, si dhe aktet e tjera nënligjore, që bien ndesh me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha